



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education,
Science, Technology and Innovation

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 018/344
Datë: 02.12.2021

Në bazë të nenit 30 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 14/9 shtator 2011) në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, shtojca 1 paragrafi 7 i Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 30.03.2021, si dhe nenit 10 paragrafi 1 të Udhëzimit administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative (GZ nr. 03/2013, dt. 16.05.2013), nxjerr:

V E N D I M

Për shfuqizimin e paragrafit 1.3 të Nenit 3 të Udhëzimit administrativ nr. 09/2021 për Aplikimin e pagesave të studentëve në universitetet publike

1. Shfuqizohet paragrafi 1.3 i Nenit 3 të Udhëzimit administrativ nr. 09/2021 për Aplikimin e pagesave të studentëve në universitetet publike.
2. Universitetet publike obligohen të harmonizojmë aktet e brendshme në pajtim me këtë vendim.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.


A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, pas kërkesës së studentëve të universiteteve publike, në pajtim me parimin e ekonomizimit të procedurës administrative, rritjes së efikasitetit të procedurës së paraqitjes së provimeve, si dhe nevojës për shfuqizimin e paragrafit 1.3 të Nenit 3 të Udhëzimit dministrativ nr. 09/2021 për Aplikimin e pagesave të studentëve në universitetet publike, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Universiteteve publike;
2. Kabinetit të Ministres;
3. DAL/MASHTI;
4. Zyrës së SP;
5. Arkivit.

Arbërie Nagavci



Ministre e MASHTI

